



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:247140
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05508007

C.nr. 53/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtar Argzon Muçaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.K. nga P., Rr. “M.K.”, Objekti..., kati..., Nr..., kundër të paditurës M.F., me seli në ndërtesën e Qeverisë së Kosovës në Prishtinë, me përfaqësues ligjor Avokaturën Shtetërore nga Ministria e Drejtësisë, si dhe ndërhyrësve në anën e të paditurës F.G. i përfaqësuar me autorizim nga R.K. avokat nga Prishtina dhe B.A. i përfaqësuar me autorizim nga Sh.F. avokat nga Prishtina, me kërkesë të padisë anulim i vendimit dhe anulim i konkursit, pas mbajtjes se seancës së shqyrtimit kryesor, me datën 26.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET NË TËRËSI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësit B.K. nga P., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. 43/2018 i të paditurës (MF, me nr. protokollit 01/1706-2 i datës 17.06.2018) si dhe konkursi i brendshëm me nr. 05.6.1/1068 i shpallur me datë 08.06.2018 nga D.K. dhe të obligohet Drejtori i Përgjithshëm i D.K. të rishpall konkursin e brendshëm duke i eliminuar të metat e konstatuara gjatë zhvillimit të procedurës së konkursit të brendshëm nr. 05.06.1/1068 i datës 08.06.2018.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi B.K. nga P., në këtë gjykatë me datë 15.11.2018 ka paraqitur padi duke kërkuar anulimin e vendimit nr. 43/2018 i të paditurës (MF, me nr. protokollit 01/1706-2 i datës 17.06.2018) si dhe konkursi i brendshëm me nr. 05.6.1/1068 i shpallur me datë 08.06.2018 nga D.K. dhe të obligohet Drejtori i Përgjithshëm i D.K. të rishpall konkursin e brendshëm duke i eliminuar të metat e konstatuara gjatë zhvillimit të procedurës së konkursit të brendshëm nr. 05.06.1/1068 i datës 08.06.2018.

Paditësi përmes padisë, ka theksuar se Komisioni intervistues nuk ka zbatuar dispozitën e nenit 53.7 të Udhëzimit Administrativ 37/2016 i cili parasheh se: “*në fund të çdo sesioni të provimit, komisioni përzgjedhës duhet të përzgjedhës duhet të përgatisë një listë të kandidatëve të shqyrtuar, dhe rezultatet përkatëse të marra do të publikohen në vendndodhjen e provimit po atë ditë.*” Bazuar në këtë, paditësi pretendon se mos publikimi i rezultateve të konkursit sipas

kërkesave të UA 37/2016, por publikimi i tyre në ditën e fundit të të gjitha intervistave gojore (ditën e fundit) paraqet shkelje të rëndë të dispozitave dhe akteve të zbatueshme nga D.K., sepse sipas paditësit kjo i ka dhënë mundësi komisionit që të ndikohet nga faktorë të ndryshëm të mundshëm, duke mos përjashtuar këtu edhe ndërhyrjet e mundshme në rezultatet e intervistave gojore në ditën e fundit të intervistave në dobi të kandidatëve të caktuar dhe interesave të caktuara. Tutje, ka shtuar se D.K. me datë 08.06.2018 ka shpallur konkursin e brendshëm nr.05.6.1/1068 në kundërshtim me dispozitat e UA nr.39/2017 për Strukturën Organizative të D.K. dhe kjo për faktin se ka shpallur konkurs të brendshëm për plotësimin e tre pozitave të lira për pozitat: “Drejtor i Drejtorisë me gradë OD6” në vend të katër pozitave sa është dashur dhe sa jen të lira, të cilat kërkohen të plotësohen me strukturën organizative të lartcekur, duke vepruar kështu në kundërshtim të plotë me nenet 4, 5, 6 dhe 7 të UA nr. 39/2017 për SO të D.K. Po ashtu, më tutje paditësi përmes padisë pretendon se përbërja e Komisionit intervistues dhe rezultati i dal nga ai janë në kundërshtim me Ligjin për Barazi Gjinore, sepse komisioni në përbërje prej 5 anëtareve, që të gjithë të gjinisë mashkullore ka vepruar në kundërshtim me nenin 54.3 të UA nr. 37/2016, i cili nen parasheh që patjetër të paktën një anëtar i komisionit përzgjedhës të jetë nga gjinia femërore. Njëkohësisht, paditësi pretendon se shpallja e konkursit të brendshëm është nënshkruar nga U.D. Udhëheqës i Burimeve Njerëzore, e cila edhe vet ishte candidate dhe ju ka nënshtruar të gjitha procedurave të konkursit të brendshëm për pozitat e drejtorëve me gradën OD6, dhe lidhur me këtë, paditësi konsideron se ekziston konflikti i interesit dhe cenim të nenit 127 të UA nr. 37/2016, e po ashtu është në kundërshtim edhe me paragrafët 8 dhe 9 të nenit 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Ka shtuar se, komisioni intervistues nuk ka vepruar sipas akteve të zbatueshme dhe as sipas parimit të meritës, objektivitetit dhe paanshmërisë, duke rënë ndesh me kërkesat e UA Nr. 37/2016 që rregullon marrëdhënien e punës së Oficerëve Doganor, konkretisht me nenin 53.7, nenin 55 dhe nenin 4 të UA të lartcekur, kjo për faktin se komisioni nuk ka marr parasysh përvojën dhe vlerësimet paraprake. Paditësi përmes padisë, më tutje ka shtuar se komisioni nuk ka zbatuar kërkesat nga nenet 55.3 dhe 55.6 të UA nr. 37/2016, i cili parasheh që testet të jenë të vulosura dhe të mbyllura si dhe pyetjet që ju behën kandidatëve duhet të përzgjidhen me short. Ka theksuar se, formulari i vlerësimit të intervistës nuk përmbante kërkesat e parapara me nenin 55.7 të UA nr. 37/2016 i cili kërkon që kandidatet do t'i nënshtrohen vlerësimit në 11 fusha përkatëse e jo në vetëm 6 sa i kishte formulari i vlerësimit. Paditësi pretendon se me rastin e vlerësimit të integritetit dhe përshtatshmërisë, komisioni ka dal jashtë detyrave dhe përgjegjësi të tij sepse një çështje e tillë nuk ishte në kompetencë të komisionit. Po ashtu, çdo here sipas paditësit, komisioni nuk ka marr në konsideratë rezultatet e punës dhe vlerësimet përkatëse lidhur me performancën e punës. Si përfundim, në fund të padisë, paditësi pretendon se komisioni nuk ka unifikuar vlerësimet e veta, duke mos marr parasysh kërkesën e formularit intervistues, lidhur me pikët e vendosura në rubrikën 2 nga njëri anëtar i komisionit, të cilat janë të pa harmonizuara me pikët e anëtareve të tjerë të komisionit (vlerësimi min. 2 pikë – max. 5 pikë) duke vepruar kështu në kundërshtim me rregullat e vlerësimit të intervistës të përcaktuara paraprakisht me formularin e intervistës dhe duke prodhuar rezultate jo meritore. Paditësi, në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se e paditura ka dështuar plotësisht që të jep përgjigje ligjore lidhur me pretendimet ankimore, e po ashtu ka dështuar të paraqet faktet pse janë të papranueshme pretendimet e paditësit. Ka theksuar se Vendimi i Ministrisë të Financave, si përgjigje në ankesë është bërë në shkelje të plotë të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme

Administrative, përkatësisht me nenin 48 paragraf 2, dhe se i njëjti vendim nuk i plotëson as kërkesat nga neni 49 i ligjit të lartcekur. Kurse, në fjalën përfundimtare, ka qëndruar prapa padisë dhe kërkesës së saj, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadia të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura në përgjigjën në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesën e saj, duke shtuar se vendimi i kundërshtuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe pretendimet e paditësit nuk qëndrojnë, për faktin se me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij. Ka shtuar se, vendimi Nr. 43/2018 i datës 21.09.2018 është në përputhje të plotë me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative për faktin se Ministri në përputhje me Rregulloren Nr. 02/2011 ka themeluar komisionin e veçantë vetëm për shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ushtruara ndaj konkursit të brendshëm të D.K.. Ka shtuar se, Ministri brenda afatit ligjor për zgjedhjen e ankesave, sipas rekomandimeve të komisionit vlerësues ka refuzuar ankesën e palës paditëse si të pa bazuar. Ka theksuar se, Vendimi i Ministrit përmban të gjitha elementet në përputhje me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe rrjedhimisht konstatimi i komisionit ad hoc për vlerësimin e ankesave se konkursi i brendshëm për Drejtor të Drejtorive në D.K. i datës 08.06.2018 është zhvilluar në përputhje të plotë me legjislacionin doganor, ka qenë shkak vendimtar që me vendimin nr. 43/2018 të datës 21.09.2018 M.F. të refuzoj ankesat e palëve. Më tutje, ka shtuar se lidhur me pretendimin e palës paditëse se nuk është bërë njoftimi i duhur për kandidatet e suksesshëm, komisioni ka vlerësuar se me datë 17.08.2018 në email adresën... është dërguar njoftimi, pas përfundimit të suksesshëm të procedurës së intervistimit për avancim për plotësimin e pozitës së punës Drejtor i Drejtorisë me gradë OD6, përmes të cilit email janë njoftuar të gjithë kandidatet në mënyrë individuale të cilët nuk janë rekomanduar nga komisioni intervistues si kandidat të suksesshëm. Në fund, ka shtuar se duke marrë për bazë se Vendimi Nr. 43/2018 i datës 21.09.2018 i Ministrisë Financave, Punës dhe Transfereve, është në përputhje me dispozitat ligjore dhe në zbatim të rekomandimit nga komisioni profesional për vlerësimin e ankesës, i njëjti duhet të mbetet në fuqi. Kurse, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se mbesim pranë përgjigjes në padi, dhe e kundërshtojmë edhe më tutje padinë dhe kërkesën e saj, duke konsideruar se vendimi i të paditurës është i drejtë dhe i bazuar në ligj, duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesën e saj të refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Përmes parashtresës së datës 07.11.2022, B.A., F.G. dhe A.S. kanë parashtruar kërkesë për ndërhyrje të thjeshtë në procedurën në anën e palës së paditur, pasi që të njëjtit kanë kuptuar se është duke u zhvilluar kontesti për anulimin e Vendimit të M.F., përkatësisht konkursit të shpallur nga D.K., dhe në këtë rast anulimi eventual i tij, u cenon të drejtat e fituara nga konkursi i kontestuar dhe prek drejtpërdrejt interesat e tyre. Gjykata me aktvendimin e marrë në procesverbal në seancën e datës 16.02.2024, pas deklarimit të palëve ndërgjyqëse, ka lejuar në cilësi të ndërhyrësit në anën e të paditurës B.A. dhe F.G. Ndërsa, në raport me parashtresën e paraqitur për ndërhyrje në këtë procedurë nga A.S., gjykata të njëjtën parashtresë e ka konsideruar të tërhequr, për faktin se i njëjti nuk ka marrë pjesë në seancë edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt.

I autorizuari i ndërhyrësit B.A. në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që pas administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke vlerësuar se vendimi i M.F. – D.K. është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi, dhe udhëzimet e tjera administrative.

I autorizuari i ndërhyrësit F.G. në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se paditësi padinë e tij nuk e ka mbështetur në asnjë provë të vetme, duke i propozuar gjykatës që padia dhe kërkesa e saj të refuzohet në tërësi si e pa bazuar, për faktin se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës mund të konstatohet se vendimi i nxjerr nga e paditura është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Më tutje, ka shtuar se sa i përket pretendimeve të paditësit, se komisioni intervistues nuk e ka zbatuar dispozitën e nenit 53.7 të UA, një konstatim i tillë është i pa qëndrueshëm për faktin se neni 53 ka titull, duke e cituar “procedurat e testimit” dhe kjo dispozitë ka të bëjë me testin me shkrim e jo me intervistën me gojë, për faktin se në konkursin, të cilit i është nënshtruar paditësi nuk është aplikuar fare testi me shkrim.

Lidhur me këtë çështje, paditësi fillimisht kishte paraqitur padi në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila Gjykatë me aktvendimin A.nr.2459/2018 i datës 16.10.2018 ishte shpallur jo kompetente në aspektin lëndor, duke i dërguar lëndën për gjykim Departamentit të Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Po ashtu, paditësi bashkë me padi në këtë gjykatë kishte paraqitur edhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, përmes së cilës kishte kërkuar pezullimin e vendimeve nr. 403/04/10/2017, 404/04/10/2018 dhe 405/04/10/2018, të cilin propozim, gjykata me aktvendimin e datës 26.03.2019 e kishte refuzuar si të pa bazuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ndërgjyqëse, në seancën e shqyrtimit kryesor ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Ankesa e paraqitur nga paditësi me datë 08.06.2018 për M.F., Vendimi nr. 43/18 i M.F., emali i datës 04.10.2018 nga V.K. dhe L.R., Raporti i projektit të binjakëzimit në mes të D.K. dhe të Doganës së Francës dhe Italisë, raporti i Bashkimit Evropian IPAA 2013 Centraliz programe – KS 13IB FI 01, Rekomandimi i M.F. i datës 09.08.2017 me nr. 437, Vendimi i D.K. i datës 21.08.2017 me nr.01447/17, Konkursi i brendshëm i datës 23.06.2017 me nr. 288, Konkursi i brendshëm i datës 08.06.2018 me nr. 05G1, Vendimi i D.K. i datës 02.08.2018 me nr. 392, Njoftimi për kandidatët e suksesshëm i datës 17.08.2018, Vendimi i datës 04.10.218 me nr. 405 nga D.K., Vendimi i datës 04.10.218 me nr. 404 dhe 403 nga D.K., Vendimet për emërimet të përkohshme të datave 08.12.2014, 22.03.2017,05.10.2017, 30.03.2018, Raporti i vlerësimit të performancës për periudhën nëntor 2014 – nëntor 2015, nëntor 2015- nëntor 2016, dhe për periudhën 01.01.2017 deri me 31.12.2017, cv-ja e paditësit së bashku me letrën motivuese, Formulari i intervistës me datë të intervistës 15.08.2018, Vendimi i M.F. me nr. 36/2018-1706, Vendimi i M.F. me nr.1706-1 i datës 18.09.2018 se bashku me rekomandimin, Njoftim i D.K. i datës 17.08.2018 dhe Formulari i intervistës në emër të paditësit B.K. i lëshuar nga D.K..

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e refuzoj kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Fillimisht, gjykata duke u bazuar në deklaratimet e palëve ndërgjyqëse konstatoj se nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune në D.K., po ashtu, nuk ishte kontestuese se me datë 08.06.2018 është hapur konkursi i brendshëm për pozitën Drejtor Drejtorie, për tri pozita të lira. Njëkohësisht, nuk ishte kontestuese, se paditësi i është nënshtruar konkursit me qëllim të avancimit në detyrë, në pozitën Drejtor Drejtorie. Po ashtu, nuk ishte kontestuese se pas zhvillimit të procedurës sipas konkursit, në këto pozita ishin përzgjedhur tre persona të tjerë, përkatësisht sipas njoftimit nga D.K. me nr. 01/353/2018 i datës 17.08.2018 si kandidat të suksesshëm ishin përzgjedhur F.G. me 144 pikë, A.S. me 142 pikë dhe B.A. me 141 pikë.

Kontestuese për paditësin ishte Vendimi i M.F. me Nr. 43/2018 me të cilin Vendim paditësit i është refuzuar ankesa, po ashtu, kontestuese për paditësin ishte shpallja e konkursit, procedura e ndjekur nga komisioni intervistues, përbërja gjinore e komisionit, shpallja e konkursit të brendshëm për plotësimin e tre pozitave në vend se të shpallej për katër pozita të cilat kanë qenë të lira. Njëkohësisht, për paditësin kontestuese ishte edhe procedura lidhur me testet, ku sipas tij të njëjtat duhet të jenë të vulosura dhe të mbyllura si dhe çështja e cila ndërlidhet me pyetjet që ju behën kandidatëve, ku sipas paditësit të njëjtat duhet të përzgjidhen me short.

Meqenëse, paditësi sipas kërkesës së tij ka kërkuar anulimin e Vendimit të lartcekur i nxjerr nga e paditura, me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së tij, gjykata e vlerësoj të gjithë procedurën e ndërmarr nga faza e aplikimit të paditësit e deri në përfundimin e saj, dhe atë sipas pretendimeve të paditësit, e duke u bazuar në provat e propozuara nga paditësi dhe provat e tjera në shkresat të lëndës.

Sa i përket pretendimit të paditësit se D.K. me datë 08.06.2018 ka shpallur konkursin e brendshëm për plotësimin e tre pozitave të lira për pozitën: “Drejtor i Drejtorisë me gradë OD6” në vend të katër pozitave sa është dashur dhe sa janë të lira, gjykata vlerëson se shpallja e pozitave të lira përcaktohet dhe vlerësohet nga vetë punëdhënësi, varësisht nga nevojat dhe planifikimet në raport me pozitën e lira të punës. Në lidhshmëri me këtë, gjykata konsideron se nuk ka ndonjë dispozitë ligjore e cila do të detyronte të punëdhënësin, për shpalljen e numrit të pozitave të lira. Andaj, bazuar në këtë, gjykata e vlerëson si të pa bazuar pretendimin e paditësit në raport me hapjen e katër pozitave të lira, në vend të tre sa kanë qenë të hapura për aplikim.

Lidhur me vlerësimin e paditësit në procesin e intervistimit të tij nga komisioni përkatës, përmes formularit të intervistës në emër të paditësit i datës 15.08.2018, konstatohet se i njëjti është vlerësuar me 124 pikë. Pikërisht mënyra e vlerësimit për paditësin ishte kontestuese, për faktin se sipas tij vlerësimet të cilat janë bërë nga secili prej anëtarëve të komisionit, kanë dallime me mbi një pikë.

Gjykata e vlerësoj këtë pretendim të paditësit, lidhur me vlerësimin e tij nga komisioni vlerësues, dhe nga formulari i lartcekur i intervistimit gjykata konstatoj se paditësi ishte vlerësuar me pikët 3 deri në 5, ndërsa në fund të formularit sqarohet se: *“Është e pritshme që Komisioni mos të vlerësoj me më shumë se një pikë diferencë”* dhe *“Në rast të vlerësimit të tillë, kryesuesi duhet të harmonizoj notat e vlerësimit bazuar në fakte dhe arsyetime përkatëse nga anëtarët e panelit intervistues.”* Gjykata e vlerësoj këtë sqarim në fund të formularit dhe pikët e vendosura nga anëtarët e komisionit, dhe nga kjo konstatohet se ekziston dallimi mbi një pikë në vlerësim.

Mirëpo, gjykata vlerëson se dallimi i vlerësimit në pikë, në diferencë me shumë se një pikë, nuk mund të ndikoj në ligjshmërinë e procesit, kjo për faktin se një mënyrë e tillë e vlerësimit nuk është detyruese me ndonjë dispozitë ligjore, dhe rrjedhimisht, vlerësimi nga ana e komisionit duhet të jetë i pavarur, që nënkupton se nuk mund të kufizohet në vendosjen e pikëve.

Në raport me pretendimet e paditësit, sa i përket ligjshmërisë së konkursit dhe gjithë procesit, fillimisht gjykata e vlerësoj përbërjen e komisionit intervistues, duke u bazuar në Vendimin e datës 01.08.2018 me të cilin vendim është formuar komisioni intervistues. Nga ky vlerësim gjykata konstatoj se i njëjti ishte në përbërje ashtu siç përcaktohet me nenin 6 paragraf 2 të Kodit Nr. 03/L-109 Doganor të Akcizave, i cili përcakton: *“Komisioni sipas paragrafit 1 pika a). dhe b). do të formohet nga Drejtori Gjeneral i Doganës në konsultim me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave prej katër anëtarëve dhe një kryetarit, i cili do të përbëhet prej përfaqësuesit udhëheqës të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, përfaqësuesit udhëheqës të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Përfaqësuesit të Këshillit për Mbrojtjen e të drejtave të njeriut, një përfaqësuesit të doganave dhe një Gjyqtar.”* Ndërsa, kjo dispozitë, me nenin 2 të Ligjit Nr. 04/L-099 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë është ndryshuar, dhe atë: *“Neni 6 i ligjit bazik, paragrafi 2 fshihet fjalia “përfaqësuesi i Këshillit për Mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe një Gjyqtar” pjesa tjetër e tekstit mbetet e pa ndryshuar.”* Lidhur me pretendimin e paditësit sa i përket përbërjes së komisionit në aspektin gjinor, dispozita e lartcekur nuk parasheh kërkesa të tilla sa i përket aspektit gjinor në përbërjen e komisionit. Mirëpo, lidhur me këtë, neni 54 paragraf 3 i Udhëzimit Administrativ Nr. 37/2016 përcakton se: *“Të paktën një anëtar i komisionit përzgjedhës, me përjashtim të ndonjë rrethane të arsyeshme do të përbëhet nga gjinia femërore, siç është paraparë me ligj.”* Në raport me këtë, e duke u bazuar në dispozitën e lartcekur nga Kodi Doganor i Akcizave lidhur me delegimin e anëtarëve të komisionit nga institucionet e tjera, gjykata vlerëson se nuk është në mundësinë e të paditurës të ndikojë në përbërjen e komisionit në aspektin gjinor, për deri sa institucionet e tjera kanë qenë ligjërisht të obliguara të dërgojnë nga një anëtar në përbërje të komisionit. Andaj, bazuar në këtë, gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit lidhur me përbërjen e komisionit vlerësues në aspektin gjinor, është i pa bazuar.

Kurse, në lidhshmëri me të lartcekurat, e duke vlerësuar pretendimet e paditësit se përbërja e komisionit ka qenë në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, gjykata konsideron se pavarësisht autorizimeve dhe obligimeve institucionale që përcakton ky ligj, në aspektin e përbërjes së komisionit nuk mund të gjej zbatim. Kjo për faktin se, siç u theksua edhe me lartë, përbërja e komisionit është diktuar në tërësi nga përfaqësuesit të cilët i kanë deleguar institucionet që kanë qenë detyrimisht pjesëmarrës në këtë komision. Për më shumë, nga provat e administruara dhe deklaratimet e palëve ndërgjyqëse, paditësi me rastin e intervistimit nuk kishte paraqitur ndonjë vërejtje në përbërjen e komisionit.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e paditësit, se UD Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore në D.K., ka qenë në konflikt interesi me rastin e pjesëmarrjes së tij në shpalljen e konkursit të brendshëm, e cila edhe vet ishte kandidate dhe ju ka nënshtruar të gjitha procedurave të konkursit të brendshëm për pozitën e drejtorëve me gradën OD6, gjykata vlerëson se lidhur me këtë nuk mund të konsiderohet se kishte konflikt interesi. Kjo për faktin se, me nenin 50 të Udhëzimit Administrativ 37/2016 për Rregullimin e Marrëdhënies së Punës së Oficerëve Doganor është

përcaktuar se burimet njerëzore janë organ kompetent për shpalljen e konkursit. Ndërsa, i njëjti Udhëzim, në nenet 51 dhe 52 parasheh se burimet njerëzore administrojnë më tërë me gjithë procesin e rekrutimit, ndërsa konkurrimi në rastin konkret, me qëllim të avancimit nuk parasheh ndonjë lloj kufizimi, e në lidhshmëri me këtë as për UD Drejtorin e Departamentit të Burimeve Njerëzore në rastin konkret.

Sa i përket pretendimeve të tjera paditësit në raport me mos respektimin e parimit të meritës, objektivitetit dhe paanshmërisë nga e paditura, gjykata e vlerësoj dhe e analizoj Udhëzimin Administrativ Nr. 37/2016, i cili ka përcaktuar parimet, procedurat dhe tërësisht rregullimin e marrëdhënies së punës, duke përfshirë, kushtet dhe kriteret për avancim në pozitë në cilindo nivel. Me neni 47 të këtij UA, është paraparë se: *“parametrat vlerësues që duhet të merren parasysh me rastin e avancimit të oficerëve doganor janë: aftësitë dhe shkathtësitë profesionale të treguara në vendin e punës, shkalla e angazhimit dhe e përkushtimit; rezultatet e arritura në punë dhe kontributi, respektimi zënia e afateve, dinamikave, efikasiteti dhe efektiviteti; cilësia e punëve të kryera; përvoja; dhe edukimi.”* Neni 49, paragraf 1 përcakton se: *“çdo oficer doganor që plotëson kriteret e parapara me këtë udhëzim administrativ ka të drejtë për të konkurruar në procesin për avancim.”* Dispozitat vijuese rregullojnë çështjet e kriterëve profesionale dhe të tjera për avancim nga një gradë në tjetrën. Parë në tërësi procesin rekrutues në fjalë, duke vepruar sipas kërkesëpadisë së paditësit e duke vlerësuar provat dhe argumentet e paraqitura nga palët ndërgjyqëse, veçmas nga pala paditëse, gjykata konsideron se nuk ka bazë ligjore për anulimin e konkursit të atakuar nga paditësi përmes padisë së tij, e rrjedhimisht as vendimin Nr. 43/2018, ndaj të cilit gjatë procesit gjyqësor është drejtuar kërkesëpadia e paditësit, andaj ka vlerësuar se kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet si e pabazë.

Pasi vlerësoj dhe analizoj të lartcekurat, gjykata konstatoj se Vendimi Nr.43/2018 i datës 11.03.2019, është marr në përputhje me nenin 78 paragraf 1 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, i cili përcakton: *“I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura”*, në përputhje më këtë dispozitë, e paditura në cilësi të organit kompetent ka marr vendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditësit. Bazuar në këtë, gjykata vlerëson se e paditura me rastin e refuzimit të ankesës, vendimin e saj e ka nxjerr duke aplikuar drejtë dispozitat ligjore të përcaktuara me Ligjin e Punë dhe aktet e tjera të brendshme. Kjo për faktin se vendimi i lartcekur, paraqet akt të vlefshëm juridik apo administrativ, i njëjti është nxjerr nga një institucion shtetëror, dhe i njëjti përmban pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin dhe këshillën juridike, andaj bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se vendimi i tillë i përmban të gjitha elementet e nevojshme me çka edhe i përmbush të gjitha kushtet ligjore si për nga përmbajtja ashtu edhe nga forma.

Si rezultat nga të lartcekurat, gjykata konsideron se paditësi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij që ngrisin çështje të ligjshmërisë së procesit të kontestuar të rekrutimit, e as ato të ligjshmërisë së akteve të kontestuara me padi.

Në bazë të nenit 322 paragraf 2 të LPK-së, është paraparë se: *“pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provoj faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.”* Në rastin konkret, gjykata gjeti se paditësi nuk e ka provuar në mënyrë të mjaftueshme të drejtën e tij si më sipër sa i përket ligjshmërisë së vendimit të

kontestuar. Me nenin 2, paragraf 1 të LPK-së është paraparë se: *“në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”*, andaj gjykata mori parasysh kërkesat e palëve me rastin e vendosjes.

Gjykata mori parasysh edhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, po ashtu, edhe provat e tjera, të cilat janë administruar në shqyrtim kryesor, mirëpo, të njëjtat nuk ishin relevante dhe nuk kishin ndonjë ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje kontestuese.

Vendimi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta të procedurës kontestimore, u bazua në nenin 450 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në nenin 143 paragraf 1 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr. 53/2019, datë 26.03.2024

Gjyqtari
Argzon Muçaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.